

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 283/2009
Prishtinë
19 prill 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancë kolegji në pajtim me nenin 26 paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 19 prill 2011 në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë nga gjyqtari ndërkombëtar Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar kolegji dhe gjyqtarët vendor të Kosovës Nesrin Lushta, Emine Mustafa, Emine Kaçiku dhe Salih Toplica si anëtar të kolegjit,

si edhe me Nexhmije Mezini dhe Jacqueline Ryan si procesmbajtëse,

në praninë e

Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës z. Johannes Van Vreeswijk dhe Nën-Prokurorit të Shtetit të Kosovës zj. Ms. Linda Heaton, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK)

Avokatit mbrojtës Bajram Tmava për të pandehurin Feriz Gashi,
Avokatit mbrojtës Bahtir Troshupa, i cili zavendëson avokatin mbrojtës Fazli Balaj për të pandehurin Hysni Gashi,
Përfaqësuesit ligjor Bajram Maraj për palën e dëmtuar Ekrem Ferati,
Përfaqësuesit ligjor Xhafer Maliqi për palën e dëmtuar Gojart Bajrami,

Në lëndën penale me numër AP-KZ 283/2009 kundër të pandehurve:



Feriz GASHI, i lindur më

babë

me emrin e parë në aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën nr. P. Nr. 10/2007 të datës 27 mars 2009 dhe regjistruar në Shkrimorën e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtor për veprat penale të mëposhtme:

Hysni GASHI, i lindur më

adresa e tanishme e banimit në

banor

me emrin e parë në aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën nr. P. Nr. 10/2007 të datës 27 mars 2009 dhe regjistruar në Shkrimorën e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtor për veprat penale të mëposhtme:

Në pajtim me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën nr. P. Nr. 10/2007 të datës 27 mars 2009 dhe regjistruar në Shkrimorën e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtor për veprat penale të mëposhtme:

I pandehuri Feriz GASHI

[i] Për kryerje të veprës penale **Vrasje e rëndë** të V. B. dhe A. XH. në 22 prill 2006 në rrugën 'Tirana' në Shtime, në të njëjtën kohë ka rrezikuar jetën e B. B., K. B., E. I., B. F. R. I., P. H., Xh. S., I. H. si edhe personave të tjerë në të njëjtin vend dhe apartamente afër vendndodhjes, në kundërshtim me nenin 147 paragrafi 1 nën-paragrafi 4 dhe 11 të Kodit Penal të Kosovës (KPK); dhe

[ii] për kryerjen e veprës penale Posedim dhe shfrytëzim i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPK;

I pandehuri Hysni GASHI

Për Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë, në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 paragrafi 1, nën-paragrafi 4 dhe 11 të KPK;

Dhe janë dënuar me sa vijon:

I akuzuari **Feriz GASHI** ishte dënuar për veprën penale Vrasje e rëndë me burgim prej njëzet e pesë (25) vite [neni 37 paragrafi 1 dhe 2 i KPK dhe neni 147 paragrafi 1, nën-paragrafi 4 dhe 11 i KPK] dhe për veprën penal Posedim dhe shfrytëzim i paautorizuar i armëve me burgim prej një (1) viti [neni 38 dhe neni 328 paragrafi 2 i KPK]. Gjykatë e shkallës së parë konstruktivoi një dënim unik prej njëzet e pesë (25) vite dhe gjashtë (6) muaj sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 pikat (2) të KPPK.



I akuzuari **Hysni GASHI** ishte dënuar për veprën penale **Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë**, me burgim prej njëzet (20) vite, [neni 38 dhe 24 në lidhje me nenin 147 paragrafi 1 pikat 4 dhe 11 të KPK].

Avokatët mbrojtës të dy të akuzuarve secili ka paraqitur me kohë ankesë kundër aktgjykimit, për **Feriz GASHIN** më 09 korrik 2009 dhe për **Hysni GASHIN** me datën 14 korrik 2009. Është deklaruar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, shkelje të kodit penal dhe dënimi i shqiptuar për dy të akuzuarit është kundërshtuar. Nga mbrojtja e të akuzuarit **Feriz GASHI** ishte propozuar anulimi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe lënda të kthehej në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, përderisa mbrojtja e të akuzuarit **Hysni GASHI** propozoi të ndryshohej aktgjykimi i kundërshtuar dhe të lirojë të pandehurin nga të gjitha akuzat.

Përveç kësaj, **dy të akuzuarit** kanë paraqitur një ankesë të përbashkët por pa ofruar argumente ligjore përpos atyre të theksuara në ankesat e avokatëve mbrojtës.


Për më tepër, **palët e dëmtuara El F** dhe **G . B** me kohë kanë paraqitur ankesa të ndara kundër aktgjykimit të shkallës së parë përmes përfaqësuesve përkatës të tyre ligjor, në këtë mënyrë në veçanti kanë goditur vendimin mbi dënimin dhe kanë propozuar ndryshimin e aktgjykimit dhe shqiptimin e burgimit afatgjatë për të dy të akuzuarit.

ZPSHK përmes mendimit të dhënë më 30 prill 2010 dhe të regjistruar në Gjykatën Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë, kundërshtoi ankesat si jo meritore dhe të pabazuara. Prandaj Prokurori Publik propozoi të refuzohen ankesat si të pabazuara dhe vërtetojë aktgjykimin e Gj.Q. Prishtinës P.Nr. 10/07 të datës 27 mars 2009.

Bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën P. Nr. 10/2007 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 27 mars 2009, ankesat e parashtruara me shkrim të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, shkresat relevante dhe paraqitjet verbale të palëve gjatë seancës së dëgjimit më 19 prill 2011 së bashku me një analizë të ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit më datën 19 prill 2011, përmes kësaj lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Në pajtim me nenin 420, paragrafi 1, pika 2, neni 423, nenet 391 dhe 392, paragrafi 1 i KPPK ankesat e avokatëve mbrojtës të paraqitura në emër të akuzuarve **Feriz GASHI** dhe **Hysni GASHI** si edhe ankesat e palëve të dëmtuara në lidhje me të akuzuarin **Hysni GASHI** kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 27 mars 2009 (P.No.10/2007) përmes kësaj **refuzohen** dhe plotësisht vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë për të akuzuarin **Hysni GASHI**.




Në pajtim me nenin 420, paragrafi 1, pika 4, nenet 391 dhe 392, paragrafi 1 i KPPK ankesat e përfaqësuesve ligjor të paraqitura në emër të palëve të dëmtuara Ekrem Ferati dhe Gojart Bajrami mbi vendimin mbi dënimin kundër të akuzuarit **Feriz GASHI pranohen** dhe aktgjykimi i shkallës së parë **NDRYSHOHET**; në vend të tij janë shqiptuar: për veprën penale **Vrasje e rëndë** burgimi prej njëzet e nëntë (29) vite [neni 37 paragrafi 1 dhe 2 i KPK dhe neni 147 paragrafi 1, nën-paragrafi 4 dhe 11 i KPK] dhe për veprën penale **Posedim dhe shfrytëzim i paautorizuar i armëve** me burgim prej dy (2) vite [neni 38 dhe neni 328 paragrafi 2 i KPK]; një dënim unik prej tridhjetë (30) vite është konstruktuar për dënimet e ndara sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 pikat (2) të KPK.

ARSYETIM

Historia e Procedurës

1. Më 22 prill 2006, bazuar në një lëndë të ekzekutimit civil që kishte të bënte me një pjesë të tokës e cila përfshinte lokalet “Cami”, kishte ndodhur një gjuajtje në Shtime në rrugën “Tirana”, në të cilin dy persona, viktimat **Vesir Beqiri** dhe **Abdullahu Xh. ...**, ishin vrarë dhe një numër i të tjerëve ishin lënduar. Pesëdhjetë e shtatë plumba municioni ishin hedhur nga një armë automatike prej lokaleve “Cami” kurse po ashtu ishte shkrepur zjarr në përgjigje nga përdorimi i armëve. Më pastaj ishin arrestuar disa të dyshimt, në veçanti, **Feriz** dhe **Hysni GASHI**, Izjah apo Izjadin Beqa, Sami Gashi, Kadri Bajrami, Burim Bajrami, Ekrem Ferati dhe Rifat Imeri ose Ymeri, të gjithë nën pretendimin se kishin marrë pjesë në gjuajtjen në fjalë, ose nga ana e familjes **Beqiri** dhe **Ferati** ose nga ana e familjës Gashi.
2. Më 25 prill 2006 Prokurori Publik paraqiti një vendim mbi Fillimin e hetimeve (PP Nr. 239-1/06 kundër të akuzuarve **Feriz GASHI** për veprat penale Vrasje e rëndë, Vrasje e rëndë në tentative, Posedim dhe shfrytëzim i paligjshëm i armëve, dhe Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe kundër të akuzuarit **Hysni GASHI** për veprën penale të Kërcënimit. Me rastin e njejtë kishin filluar hetimet kundër të dyshimtëve **Izjah BEQA** për veprën penale Posedim i paligjshëm i armëve, **Sami GASHI** për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, **Kadri BAJRAMI** për veprat penale Posedim i paligjshëm i armëve dhe Pengim i personave zyrtar në Kryerjen e detyrave zyrtare si edhe kundër **Burim BAJRAMI**, **Ekrem FERATI** dhe **Rifat IMERI** për veprën penale Posedim i paligjshëm i armëve.
3. Më 21 shtator 2006 Prokurori Publik zgjeroi hetimet kundër **Hysni GASHI** dhe futi në hetime veprën penale Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë.
4. Më 20 tetor 2006 gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës vazhdoi hetimet për gjashtë muaj shtesë kundër të gjithë të pandehurve duke i përfshirë në Vendimin e Fillimit të Hetimeve.



5. Më 10 janar 2007 Prokurori Publik pushoi hetimet kundër të dyshimëve Izjah BEQA, Ismajl BEQA, Sami GASHI, Blerim GASHI, Ekrem FERATI dhe Rifat IMERI në lidhje me veprat penale sikurse është përmendur në vendimin e Fillimit të hetimeve.

6. Në të njejtën ditë, Prokurori Publik paraqiti aktakuzën në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës kundër të akuzuarit **Feriz GASHI** për veprat penale Vrasje e rëndë dhe Mbajtje, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe kundër të akuzuarit **Hysni GASHI** për veprën penale Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë.

7. Më 06 mars 2007 gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, pas mbajtjes së seancës së konfirmimit, konfirmoi aktakuzën kundër dy të akuzuarve për veprat penale sikurse janë renditur në aktakuzë.

8. Shqyrtimi kryesor filloi para kolegjit me gjyqtarë të Kosovës më 18 qershor 2007 dhe ishte caktuar tërësisht përmes tetë seancave po ashtu më 10 shtator 2007, 15 tetor 2007, 26 nëtor 2007, 08 janar 2008, 25 shkurt 2008, 27 mars 2008 dhe 21 prill 2008.

9. Gjatës seancës së fundit më 21 prill 2008 Kryetari i kolegjit caktoi një vizitë të vendit të krimit për datën 15 maj 2008 dhe një seancë gjyqësore të mëtejme më 23 qershor 2008. Megjithatë kjo e fundit nuk u mbajt asnjëherë dhe një Kryetar kolegji tjetër u caktua në këtë lëndë.

10. Pas letrës së të akuzuarit **Feriz GASHI** i cili kërkonte që lënda të shqyrtohej nga gjyqtarët e EULEX-it, kryetari i kolegjit më 03 dhjetor 2008 kërkoi me shkrim marrjen e lëndës nga EULEX-i. Më datën 12 dhjetor 2008 Kryetari e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it lëshoi një vendim duke i caktuar gjyqtarët e EULEX-it në këtë lëndë.


11. Më pastaj shqyrtimi kryesor filloi më 11 shkurt 2009 para trupit gjykues, të kryeruar nga një gjyqtar i EULEX-it. Me atë rast aktakuza ishte lexuar nga Prokurori Publik dhe dy të akuzuarit, të cilët ishin në shoqërim të avokatëve përkatës të tyre mbrojtës, të dytë u deklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Po ashtu gjykata dëgjoji dëshmitë e dëshimtarëve dhe palëve të dëmtuara Rifadije Jashari dhe Xhemajl Smajli.

12. Më 12 shkurt 2009 u dëgjuan dëshmitarët B. Ba. i, R. Im. dhe H. H. i përderisa më 19 shkurt 2009 u morrën dëshmitarët B. Ba. ii, F. Fer. i, H. H. i dhe A. A. i, që të gjithë në seancë të hapur.

13. Po ashtu në seanca të hapura ishin marrë në pyetje dëshmitari N. T. i dhe Eksperti i Mjekësis Ligjore Dr. Tefik Gashi dhe Eksperti Balistikës Rreshtari i. R. i Lutfi Rraci.

14. Më 05 mars 2009 gjykata dëgjoji dëshmitë e dësh. tarit S. S. i, M. M. i dhe S. S. i e mëposhtme në shënime:

- Raporti i vendit të ngjarjes



- Skica e vendit të ngjarjës me shpjegime
- Rekomandimi (në shqip, sikurse është bashkangjitur në Raportin e Policisë)
- Dokumenti me përshkrim të fotografive nga 1-376
- Raporti i Njesis Policore të Ferizajit
- Raporti i Autopsisë
- Përshkrimi i fotografive nga autopsia
- Albumi i fotografive të autopsisë me 91 fotografi
- Një Raport i mëtejme i vendit të ngjarjës
- Skica e datës 27 prill 2006
- Raporti i dytë i Zingjirit të Paraburgimit
- Lista tjetër e fotografive e datës 27 prill 2006
- Rekomandimi
- Raporti kriminal i datës 22 prill 2006
- Lista tjetër e fotografive e datës 27 prill 2006
- 33 fotografi
- Raporti mjekësor i shkruar nga Dr. Tefik Gashi, i datës 18-20 qershor 2007
- Raporti i Balistikës i datës 25 gusht 2006
- Deklarata e Besnik Feratit
- Vendimet gjyqësore dhe dokumentet në lidhje me kërkesën civile të pronësisë.


15. Në të njejtën seancë gjykata vazhdoi me marrjen në pyetje të akuzuarve **Feriz dhe Hysni GASHI**, të cilët të dy kërkuan që të largohej publiku, në pajtim me nenin 329 paragrafi 4 i Kodit të Procedures Penale të Kosovës (KPPK). Kërkesa ishte pranuar brenda kufizimeve të nenit 330 të KPPK. **Hysni GASHI** deklaroi, përderisa Feriz Gashi vendosi të heshtë, për shkak të pamjaftueshmërisë të supozuar të masave përkatëse. Marrja në pyetje e **Hysni GASHIT** vazhdoi më 12 mars 2009.

16. Më 24 mars 2009 gjykata dëgjoji deklaratatata e fundit. Në fund të dëgjimit i akuzuari **Feriz GASHI** kërkoi të lirohej që të mos jetë i pranishëm në shpalljen e aktgjykimit, gjë që u pranua nga trupi gjykues.

17. Aktgjykimi ishte shpallur publikisht më 27 mars 2009 dhe aktgjykimi i ishte komunikuar të akuzuarit Feriz GASHI, për shkak të mungesës së tij të lejuar, në qendrën e paraburgimit, ku ishte mbajtur.

18. Avokatët mbrojtës të të dy të akuzuarve secili me kohë paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, për **Feriz GASHIN** më 09 korrik 2009 dhe për **Hysni GASHIN** me datën 14 korrik 2009.

Mbrojtja e të akuzuarit **Hysni GASHI** në veçanti goditi shkeljen esenciale të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK, sepse dispozitivi do të ishte kundërthënës në brendinë e tij dhe për më tepër nuk do të mbështetej plotësisht nga gjetjet faktike të Gjykatës sikurse është reflektuar në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër, Aktgjykimi është kundërshtuar për shkak të shkeljes së ligjit penal pasi që Gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar nenin 24 të KPK-së, për shkak se kushtet për Shtytje nuk ishin përmbushur në lidhje me veprimet e të akuzuarit **Hysni GASHIT**.



Gjithashtu, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar nga shkalla e parë sepse jo të gjitha provat janë mbledhur dhe vlerësuar në mënyrë të duhur.

Mbrojtja e të akuzuarit **Feriz GASHIT** ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje të ligjit penal, prandaj duke e marrë mendimin se neni 147 i KPK-së është aplikuar gabimisht, pasi që gjykata nuk e ka marrë parasysh se i akuzuari **Hysni GASHI** ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së domosdoshme.

Gjithashtu, dy të akuzuarit kanë paraqitur një ankesë të përbashkët, mirëpo ajo nuk ka përmbajtje tjetër nga ato të avokatëve mbrojtës. I akuzuari **Feriz GASHI** në veçanti ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka zhvilluar testimet shtesë të mjekësisë ligjore.

Që të katërtit, dy avokatët mbrojtës si dhe të akuzuarit kanë kundërshtuar vendimin mbi dënimin siç është përcaktuar nga Gjykata e shkallës së parë.

Prandaj, mbrojtja ka propozuar në lëndën e të akuzuarit **Feriz GASHI** që të anulohet aktgjykimin i shkallës së parë dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rigjykim, kurse në lëndën e **Hysni GASHIT** ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimin i kundërshtuar dhe i pandehuri të lirohet nga të gjitha akuzat.

19. Palët e dëmtuara E, F dhe C t B. kanë paraqitur me kohë ankesa të ndara kundër aktgjykimin të shkallës së parë përmes përfaqësuesve të tyre ligjor, në veçanti duke kundërshtuar vendimin mbi dënimin dhe duke propozuar ndryshimin e aktgjykimin dhe shqiptimin e burgimit afatgjatë ndaj dy të akuzuarve.

20. ZPShK-ja, përmes mendimit të datës 30 prill 2010, i regjistruar në Gjykatën Supreme të Kosovës në po të njëjtën ditë, ka kundërshtuar ankesat si jomeritore dhe të pabazuara. Prandaj, Prokurori publik ka propozuar që ankesat të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet aktgjykimin i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 10/07, i datës 27 mars 2009.

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkelja substanciale e dispozitave të Procedurës Penale

Shkelja e procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së:

21. Avokati mbrojtës i të akuzuarit **Hysni GASHIT** ka theksuar se aktgjykimin i shkallës së parë në mënyrë esenciale ka shkelur Ligjin e Procedurës Penale, pasi që në dispozitivin e tij është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në përmbajtjen e tij dhe në drejtim të arsytimit. Prandaj, neni 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së është shkelur. Në veçanti, dispozitivin si i tillë thotë "... qëllimisht ka shtytur birin e tij **Feriz Gashin** [s. E] që të kryejë veprën penale Vrasje e rëndë në rrethanat e përshkruara në pikën 1 në listën e pikave të kësaj aktakuzë...", përderisa në vend të kësaj është dashur t'i referohet



aktgjykimit. Për më tepër, arsyetimi – nëse nuk mungon plotësisht – është i papranueshëm dhe në kundërshtim me procesverbalin në shkresat e lëndës, pasi që nuk ka pasur asnjë provë për çfarëdo shtytje të kryer nga **Hysni GASHI**.

22. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë nuk e shkel në mënyrë esenciale nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së. Dispozitivi lidhur me të akuzuarin **Hysni GASHIN** thotë si në vijim:

“1)...

2) **Hysni Gashi** shpallet fajtor

Për Shtytjen për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë në kundërshtim të neneve 24 dhe 147, par. 1, nënpar. 4 dhe 11 të KPK-së.

Sepse dy të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprat penale siç janë akuzuar në aktakuzën e paraqitur nga Prokurori Publik dhe veçanërisht: ...

Hysni Gashi

2. Më 22 prill 2006 në orët e mëngjesit, në rrugën “Tirana” në Shtime, në shtëpinë ku ai jetonte me familjen e tij, qëllimisht e ka shtytur djalin e tij Feriz Gashin (tani i pandehur) që të kryejë veprën penale “Vrasje e rëndë” sikur në të gjitha rrethanat e përshkruara në pikën 1 të aktakuzës, dhe ai e ka bërë tërë këtë duke qenë i motivuar nga një mosmarrëveshje që ai ka pasur me palët K. B. dhe E. F., të cilët më herët në mënyrë ligjore kishin blerë një pjesë të parcelës tij nga një pornar Serb, në të cilën gjenden dy objekte afariste me emrin “Cami”, dhe të cilat ishin uzurpuar nga i pandehuri Hysni dhe një shtëpi në të cilën i pandehuri Hysniu jetonte me anëtarët e familjes së tij që nga viti 1999, në atë mënyrë që derisa Kadri Bajrami dhe Ekrem Ferati më 22.04.2006, rreth orës 09:30, kishte organizuar rrënimin e e këtyre dy objekteve të cilat gjenden përgjatë rrugës “Tirana” në mënyrë që ta liroj hapësirën për ata dhe ti përdorte ato për nevoja të tyre, dhe kur i pandehuri Hysniu është kthyer nga Stacioni i Policisë në Shtime, para pak kohe, dhe duke qenë i vetëdijshëm për faktin se ato dy lokale do të rrënoheshin atë mëngjes, e ka bindur djalin e tij, të pandehurin Feriz Gashin se nëse anëtarët e familjes së K. B. dhe Ekrem Ferati tentojnë që t’i rrënojnë objektet e lartpërmendura, t’i qëlloj ata me armë automatike dhe në asnjë mënyrë mos ta lejojë rrënimin e tyre, për të vetmen arsye për mos ta liruar parcelën në fjalë dhe objektet nga posedimi faktik i tyre, dhe kjo është si në të vërtetë ka ndodhur, kur në po të njëjtën ditë më 22.04.2008 rreth orës 09:30, i pandehuri Feriz Gashi kishte privuar nga jeta me armën e tij automatike tani të ndjerët V. B. dhe A. X., dhe gjithashtu kanë tentuar që ta privoj nga jeta të gjuna patet e dëmtuara siç është cekur në pikën 1 të aktakuzës, duke iu shkaktuar lëndime trupore.

Për arsyet e lartpërmendura kolegji shqipton këtë



26. Avokati mbrojtës i të akuzuarit Feriz GASHIT si dhe vetë i akuzuari kanë kundërshtuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur Ligjin Penal në dëm të **Feriz GASHIT**, pasi që ai është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë sipas nenit 147 paragrafit 1 nënparagrafëve 4 dhe 11 të KPK-së si dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së. Nuk është marrë parasysh fakti se i akuzuari ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së domosdoshme sipas nenit 8 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së. Për më tepër, edhe pse nuk ka qenë i autorizuar nga i akuzuari **Feriz GASHI**, avokati mbrojtës i **Hysni GASHIT** i është referuar **Feriz GASHIT** duke deklaruar se neni 147 i KPK-së është vetëm dispozitë ndëshkuese.

27. Gjkata Supreme e Kosovës në rend të parë sqaron se neni 147 i KPK-së përmban të dyja, veprën penale të cilësuar si dhe dispozitën ndëshkuese. Në veçanti, neni 147 pikat 4 dhe 11 të KPK-së, siç janë aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, përcaktojnë si në vijim:


“Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili...

4) Privon nga jeta pesonin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; ...

11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi; ...”

Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar nenin 147 të KPK-së në mënyrë të duhur.

Përkundër diskutimit të mëhershëm të pyetjes së dispozitave të ngjashme të ligjit të mëparshëm të cilat ishin vetëm dispozita ndëshkuese ose cilësuese të veprës penale, në veçanti në lidhje me nenin 47 të Kodit Penal të Serbisë (Srzentiq, Nikola; Stajiq, Dr. Aleksandar; Kraus, Dr. Bozidar, Lazareviq, Dr. Ljubisa; Djordjeviq, Dr. Miroslav; Komentari i Ligjeve Penale të Serbisë, KSA e Kosovës dhe KSA e Vojvodinës; 1981 në: “Administratën Bashkëkohore”; Beograd; (neni 47 i KPS; pika 11), versionet e komentareve të ri të nenit 47 të KPS-së nënvizojnë se “kjo vepër penale ekziston vetëm atëherë kur së paku dy apo më shumë persona janë privuar nga jeta. Nëse vetëm një person është privuar nga jeta dhe ka pasur tentime që të privohet nga jeta personi tjetër, ajo nuk përbën vrasje në tentativë nga pika 6) nëse kryerësi ka paramenduar vrasjen e disa personave; nëse ka ndodhë e kundërta, ajo do të konsiderohet bashkim real në mes të vrasjes së kryer dhe vrasjes në tentativë”. (Srzentiq, Nikola; Ljubisa Lazareviq; Komentari i Kodit Penal të Serbisë 1995; Botimi i 5-të në: “Administratën Bashkëkohore”; Beograd; (neni 47i KPS-së;pika 9)).




Kjo e fundit është dhënë në lëndën në fjalë. Gjykata Supreme kupton se edhe kur KPS-së ishte ende i aplikueshëm ka ekzistuar së paku një tendencë për ta trajtuar dispozitën përkatëse si cilësim të veprës penale të Vrasjes.

28. Sa i përket shqetësimit të avokatit se i akuzuari **Feriz GASHI** ka vepruar në kushte të mbrojtjes së domosdoshme, referencë i bëhet gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë të cekura në faqet 8-10, 11-12 dhe 14-16 të aktgjykimit të kundërshtuar (versioni në anglisht). Gjykata e shkallës së parë plotësisht ka analizuar provat, në veçanti ato të dhëna nga dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspert, mirëpo gjithashtu edhe provat e mjekësisë ligjore të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në bazë të të gjitha dëshmive, gjykata ka konstatuar se ishte **Feriz GASHI** ai i cili kishte hapur zjarr, i armatosur me armë automatike dhe ai kishte shtënë disa rafale, pa qenë në gjendje që palët e dëmtuara të reagojnë fare dhe, për më tepër ka hedhur tri granata të dorës të cilat fatbardhësisht nuk kanë eksploduar. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se përfundimisht palët e dëmtuara kanë vepruar në kushte të mbrojtjes së domosdoshme, kur kanë filluar t'i përgjigjen zjarrit të të akuzuarit **Feriz GASHIT**, duke i përdorur revolet e tyre.

29. Gjykata Supreme e Kosovës, në veçanti ndan mendimin e vlerësimit juridik të Gjykatës së shkallës së parë siç është cekur në faqet 17-18 të aktgjykimit të kundërshtuar (versioni në anglisht), sipas të cilit i akuzuari **Feriz GASHI** ka pranuar kryerjen para Prokurorit Publik gjatë fazës së hetimeve dhe kjo deklaratë është dëshmi e pranueshme në gjykatë sipas nenit 156 të KPPK-së. Përveç kësaj, vlen të përmendet në kontekstin e dhënë se gjatë fjalës së tij përfundimtare në fund të seancës ankimore i akuzuari ka deklaruar: *“Unë kam bërë gjithçka që ka qenë e mundur për të mos ardhur deri te këto vrasje. Dhe Komandanti i Policisë më ka thënë se ata do të jenë aty. Si mund të veprojnë ndryshe nga ajo që kam bërë duke u munduar që ta mbroj familjen time, siç kam bërë më parë me njerëzit. Unë kam qenë ushtar i UÇK-së ”* (procesverbali i seancës ankimore, faqe 8 e versionit në anglisht).

30. Përfundimisht, Gjykata Supreme lidhur me këtë i referohet gjykimit të saj siç është vërtetuar në lëndën *Runjeva, Axgami dhe Dema (Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-KZ 477/05 të datës 25 janar 2008, faqe 20 (versioni në anglisht)*, sipas të cilit “Procedura ankimore në KPPK, mbështetet në parimet se varet nga gjykata që të dëgjojë, vlerësojë dhe peshojë provat në trupin gjykues. [...] Prandaj, kolegji i apelit duhet t'i jep trupit gjykues hapësirë të konsiderueshme për nxjerrjen e gjetjeve faktike të saj. Nuk duhet t'i çrregullojë gjetjet e trupit gjykues për t'i zëvendësuar të vetat, përveç nëse provat në të cilat janë mbështet trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga cilado gjykatë e arsyeshme e fakteve, ose ku vlerësimi i tyre ka qenë “tërësisht i gabuar”. Ky gjykim është përsëritur dhe zhvilluar më tutje në lëndët tjera, në veçanti në lëndën kundër Florim Ejupit (*Gjykata Supreme e Kosovës, Pkl-Kzz 71/09 e datës 10 tetor 2009*) dhe kundër Jeton Kiqinës (*Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz.Nr.84/2009 e datës 3 dhjetor 2009*).



kërcënuar viktimës me këto fjalë (dëshmia e Bujar Baširi në shqyrtimin e datës 12 shkurt 2009): 'Unë i kam hapur dy varre dhe ata janë të gatshëm. Njëri është për ty ndërsa tjetri familjen Ferizit'. Kërcënime të ngjashme kundër atyre që po kërcënonin me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit, ishin bërë nga i akuzuari Hysni edhe ndaj Rifat Ismaili i cili kishte vizituar dyqanin e Hysniut për ta qepur një copë stof' (f. 23 e versionit në anglisht).

34. Gjykata Supreme e Kosovës gjatë rishqyrtimit të shkresave të lëndës ka kontrolluar të gjitha procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor dhe ka gjetur se përveç Bujar Baširit dhe Hysni Hysniut, edhe Kujtim Ferizi kishte deklaruar më 19 shkurt 2009 se e kishte takuar **Hysni GASHIN** në disa raste personalisht pasi që nuk kishte pasur me të ndonjë problem më herët. "[Gjatë] njërit nga këto takime [...] ku ishin të pranishëm edhe disa njerëz me autoritet, ne u takuam në shtëpinë e **Hysni GASHIT** e cila ndodhet në vendin e uzurpuar. Gjatë atij takimi, ku ishin të pranishëm tre pleqnarët A. E. Sh. M. dhe A. XI [...] edhe unë isha i pranishëm së bashku me babain e El... - Is... Ferizi dhe **Hysni GASHIN**". Rezultati i këtij takimi ishte "...zero sepse **Hysni GASHI** në praninë e këtyre burrave m'i tha këto fjalë: 'Do ta vras secilin që futet në këtë tokë'. Unë i thashë se nuk mund të flas me njerëz që duan të vrasin edhe pas përfundimit të luftës. Dola jashtë dhe pas pak edhe burrat tjerë dolën... Ky takim u mbajt në vitin 2004'. Pas përshkrimit të dy takimeve të tjera me **Hysni GASHIN**, së paku njëri prej tyre me praninë e "pleqnarëve" të përmendur, të cilët u bënë në vitin 2006, dëshmitari Kadri Bajrami ka theksuar se pasi që të gjitha këto negociata nuk arritën asnjë sukses, ai kishte shkuar në stacionin policor të Shtimes dhe kishte biseduar me Zëvendës Komandantin. Gjatë takimit të fundit të tyre, i cili ishte mbajtur "një ditë para incidentit", në të cilin dëshmitari kishte deklaruar se "Kam marrë pjesë së bashku me nipin Arben Bajrami, **Hysni GASHIN** dhe djalin e tij **Feriz GASHIN**. [...] Vlen të përmendet se madje edhe gjatë këtij takimi **Hysni GASHI** na është kërcënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. [...] Këto kërcënime ishin të njëjta sikur përpara, 'Do të vras ose ty, ose V... Baširi ose Is... Ferizi'" (procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 19 shkurt 2009, f. 4 - 6).

35. Për më tepër dëshmitari A. M. në 19 shkurt 2009 para gjykatës ka deklaruar se një javë para incidentit kishte çuar një palë pantallona tek i akuzuari **Hysni GASHI** për t'ia shkurtuar, sepse gjithmonë shkonte në dyqanin e tij për punë rrobaqepësie, ku gjatë bisedës i akuzuari **Hysni GASHI** i kishte thënë: "Do ta vras doktorin V... [...] se m'i ka sjellë zyrtarët e gjykatës dhe policinë prej Ferizajit dhe më ka detyruar që t'i heq plaçkat prej shtëpisë" (procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 19 shkurt 2009, f. 33).

36. Në fund, dëshmitari Sl. M. i cili kishte marrë pjesë në negociata të shumta në mes të familjeve të K. Baširit dhe të **Hysni GASHIT** në cilësinë e "pleqnarit" ka deklaruar se ditën pas të shtënave i akuzuari **Hysni GASHI** e ka thirrur në telefon dhe ka kërkuar nga ai që "të lus t'i mbash fjalët që i kemi diskutuar më herët në lidhje me palën tjetër" dhe se gjatë kësaj telefonate ai i kishte thënë se 'personi që ka qenë me ty i cili nuk ka pasur interes në këtë punë, tashmë është vvarë ose do të vritet'. Ky person është A. XI. Ai i kishte thënë 'ti je i vetmi person që ka ndërmjetësuar në këtë punë pa asnjë interes personal prej kësaj pune, prandaj po të lus të qëndrosh pranë asaj që kemi



biseduar gjatë bisedave tona''' (procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 5 mars 2009, f. 4 dhe f. 6).

37. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se fatkeqësisht aktgjykimi i shkallës së parë lidhur me përgjegjësitë e të akuzuarit **Hysni GASHI** është mjaft spekulativ të mos themi hipotetik, kur bëhet fjalë për vlerësimin e asaj se çfarë kishte ndodhur para incidentit dhe si mund të lidhej me të i akuzuari **Hysni GASHI**. Ky i fundit në veçanti i referohet shqyrtimit të gjykatës së shkallës së parë për lidhjen shkakore në mes të të shtënave të të akuzuarit **Feriz GASHI** me nxitjen / shtytjen nga babai i tij, i akuzuari **Hysni GASHI**, siç thuhet në faqen 21 të Aktgjykimit të kundërshtuar.

Për më tepër, siç është thënë tashmë, Gjykata nuk është aq e përpiktë lidhur me provat e përdorura me rastin e nxjerrjes së këtyre konstatimeve.

Neni 396 paragrafi 7 i KPK-së përcakton që [G]jykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë. Gjykata gjithashtu [...] vlerëson [...] arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.


38. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë deri diku i ka adresuar të gjitha pikat relevante të përmendura në Aktgjykimin e kundërshtuar.

Ka përmendur që përveç **Bajram Bajrami** dhe **Hysni GASHI** edhe dëshmitarët e tjerë kanë konfirmuar që i akuzuari **Hysni GASHI** u është kërcënuar anëtarëve të familjes **Bajrami** dhe **Feriz GASHI** (f. 23 e versionit në anglisht), duke iu referuar dëshmime të përmendura më lart të **Kadri Bajrami**, **Arif M. Bajrami** dhe **Selvi Bajrami**. Për më tepër, negociatat e gjata dhe të komplikuar me pjesëmarrjen e tre "pleqnarëve" janë adresuar dhe janë përmendur edhe një herë në deklaratat e **Kadri Bajrami** dhe të **Selvi Bajrami** gjatë shqyrtimit gjyqësor.

39. Nga të gjitha dëshmitë e përmendura bëhet e qartë arsyeja pse Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se **Hysni GASHI** kishte rolin vendimtar në të shtënat të cilat do të vinin më vonë si dhe në pasojat e tyre më 22 prill 2006.

40. E fundit por jo edhe më e parëndësishmja është se edhe Gjykata e shkallës së parë ka përmendur faktin se në një rast i biri i **Hysni GASHI**, i bashkakuzuari **Feriz GASHI**, ka qenë i pranishëm, kur **Hysni GASHI** në fund kishte thënë 'Do të vras ose ty, ose **Vesir Bajrami** ose **Iskender Feriz GASHI**'. Kështu pra, i është referuar dëshmisë së **Kadri Bajrami** të dhënë para Gjykatës.

41. Shumëçka mund të thuhet lidhur me çështjen nëse vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë mbi motivet e kryerësit **Feriz GASHI**, është i saktë apo jo lidhur me pretendimet për strukturën tradicionale të shoqërisë shqiptare kosovare. Nuk është aspak bindëse të besojmë se **Feriz GASHI** nuk do të kishte pasur asnjë motiv për vrasje po të mos ishte



ndërhyrja e babait të vet. Edhe po të merren parasysh struktura dhe raportet tradicionale brenda familjes GASHI (dhe vërtet përfshirja e tre pleqnarëve në rolin e ndërmjetësve është argument për këtë gjë), **Feriz GASHI** si djali më i madh i kësaj familjeje do të bëhej trashëgimtari dhe pasardhësi i babait si kryefamiljar, posa ky i fundit do të bëhej tepër i moshuar për t'i udhëhequr si duhet punët e familjes. Prandaj, natyrisht se ka mundur të kishte motiv për t'i kryer këto vrasje edhe duke vendosur vetë për këtë gjë.

42. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk e ndërron vlerësimin e provave të kryer nga shkalla e parë, siç ka vepruar edhe në shumë raste të tjera. Në këtë rast, prania e **Feriz GASHIT** gjatë takimit të babait të tij **Hysni GASHI** me K... dhe me të tjerët një ditë para vrasjes është evidente dhe fakti që ai ka qenë i vetëdijshëm për kërcënimet e shprehura nga i ati **Hysni GASHI** për t'i vrarë anëtarët e atyre familjeve, në rast se ata guxojnë që t'i rrënojnë lokalet në fjalë është e arsye e mjaftueshme për të besuar se **Feriz GASHI** së paku është bërë edhe më i fortë gjatë vendimit të tij për të shtënë të nesërmen në drejtim të familjeve B... dhe F...

43. Natyrisht mund të parashtrohet pyetja nëse kjo gjendje paraqet më shumë një veprim të **Hysni GASHIT** i cili mund të vlerësohet si ofrim i ndihmës ndaj **Feriz GASHIT** (sipas Nenit 25 të KPK-së), i cili mund të ketë pasur ndërmend të vrasë pjesëtarët e atyre familjeve, apo nëse **Hysni** dhe **Feriz GASHI** do të mund të konsideroheshin si bashkëkryerës, sipas Nenit 23 të KPK-së. Të dy këto variante mund të kryhen me paramendim, ndërsa bashkëkryerja mund të kryhet bile edhe nga pakujdesia, po qe se situata në fjalë do të mundësonte një vlerësim të tillë (*Ljubisa Lazarevic; Komentim i Kodit Penal të RFJ-së; 1995; botimi i pestë; "Savremena Administracija" Beograd; Neni 25, pika 1.(a)*).

44. Megjithatë, përkundër asaj që provat e mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk mund të ofrojnë informata të mjaftueshme sa i përket anës subjektive të të dy varianteve të përmendura të bashkëveprimit në vepra penale, situata e përshkruar plotëson kushtet e shtytjes / nxitjes si "*formim të vendimit të një personi tjetër për të kryer një vepër të caktuar penale ose për ta përforcuar edhe më tej atë vendim*" (*Ljubisa Lazarevic; Komentim i Kodit Penal të RFJ-së; 1999; botimi i pestë; "Savremena Administracija" Beograd; Neni 23; pika 1*). Për më tepër, përsëritja e kërcënimeve për vrasje e cila është shprehur në mënyrë ekskluzive vetëm nga ana e **Hysni GASHIT** para incidentit me të shtëna qysh nga viti 2004, e bën si shumë të mundur mundësinë që si kryefamiljar i familjes GASHI, ai ka pasur rolin e "organizatorit ideor" të këtyre të shtënave dhe vrasjeve.

45. Sa i përket gjendjes mendore të të akuzuarit **Hysni GASHI** që ta nxisë të birin e vet për të kryer vrasjen në fjalë, neni 24 i KPK-së përcakton që shtytësi "*...me dashje e shtyt tjetrin të kryejë vepër penale ...*".

Në këtë aspekt, mund t'i referohemi përsëri komentimeve të ligjit të vjetër, në veçanti neni 23 si dhe neni 25 të KP të RSFJ-së. Ky i fundit, lidhur me "tëndën në fjalë", përcakton sa vijon:



(1) *Bashkezekutori është përgjegjës penalisht brenda kufijve të dashjes ose të pakujdesisë së vet, ndërsa shtytësi dhe ndihmësi – brenda kufijve të dashjes së tyre”.*

(2) ...

Komentaret shpjegojnë se përderisa “për bashkëfajtorin të dy format e fajësisë janë të mundura – të dyja të dashjes dhe të pakujdesisë, [...] shtytësi dhe ndihmësi janë përgjegjës penalisht vetëm nëse ata me dashje kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës” (Ljubisa Lazarevic; Komentaret e Kodit Penal të RSFJ-së; 1995; botimi i 5-të; “Savremena Administracija” Beograd, neni 25, pika 1. (a)).

46. Pas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë është e pakontestueshme që **Hysni GASHI** dëshiroi të krijoj një shembull dhe ka vrarë anëtarë të caktuar të familjes E dhe F e gjithashtu edhe ata që i kanë përkrahur ata. Kjo bëhet më e qartë duke marrë parasysh deklaratat e dëshmitarit siç janë vënë në pah para këtij aktgjykimi. Bile **Hysni GASHI** ka përmendur emrin e tani të ndjerit V B si viktimë të preferuar të vrasjes e gjithashtu ka bërë reference në të ndjerin A X, kur ai e ka kërcënuar “plakun tjetër të fshatit”, dëshmitarin S M, se do ta vras.

47. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës arrin te opinionin që vlerësimi i gjendjes mendore të akuzuarit **Hysni GASHI** siç është kryer nga gjykata e shkallës së parë është ngushtë e lidhur me provat e mbledhura dhe mund të përcillet.


48. Sa përket dashjes së **Hysni GASHIT** që ta motivojë djalin e tij **Feriz GASHI** për të shtënat dhe vrasjet, Gjykata Supreme e Kosovës sa i përket kësaj i referohet interpretimit të gjykatës së shkallës së parë. Prania e **Feriz GASHIT** gjatë kërcënimit të fundit të **Hysni GASHIT** e bën shumë të mundshme që **Feriz GASHI** ishte i vetëdijshëm për planet e babait të tij. Për më tepër, fakti që pas të shtënave **Hysni GASHI** ka marr armën e sapo shkrepur nga duart e djalit të tij e bën të mundur për të besuar që ka ekzistuar marrëveshje e brendshme në mes të dy të akuzuarve lidhur me incidentin e të shtënave.

49. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës e ndan mendimin e Gjykatës së shkallës së parë që gjendja mendore e të akuzuarit **Hysni GASHI** dhe dashja e tij që të ketë të shtëna dhe vrasjet e kryera është pothuajse e kualitetit të njëjtë sikur se ajo e kryesit kryesor **Feriz GASHIT**.

C. Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike

I. Pretendimi për paraqitje jo të plotë të provave për të dëshmuar fajësinë e të akuzuarit **Hysni GASHI**:

50. Avokati mbrojtës i të akuzuarit **Hysni GASHI**, për më tepër ka vënë në pah se Gjykata e shkallës së parë në opinionin e saj nuk ka administruar ose paraqitur prova të mjaftueshme për të vërtetuar ndonjë fajësi të akuzuarit. Prandaj, në kundërshtim të nenit 402 paragrafit 1 pikës 3 të KPPK-së gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar



gjendja faktike. Në veçanti, ligji civil dhe prona e lidhur me historikun e situatës nuk është vlerësuar në mënyrë të duhur.

51. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Gjykata e shkallës së parë ka bërë një vlerësim shumë të detajuar të të gjitha provave në dispozicion lidhur me lëndën, në përgjithësi dhe në detaje lidhur me secilën pjesë të provave veç e veç. Referencë i është bërë posaçërisht fq.8-10, 11-12 dhe 16-17 e gjithashtu edhe 19-21 të aktgjykimit të kundërshtuar (version në gjuhën angleze) e gjithashtu edhe asaj që është vënë në pah para kësaj në këtë aktgjykim nën pikën B.II.


Shqetësimi përkatës në veçanti ishte i ngritur nga i akuzuari **Hysni GASHI** gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 24 mars 2009, kur i akuzuari pas fjalës përfundimtare të Prokurorit Publik deklaroi: “Aktakuza e ngritur kundër meje dhe djalit tim është mënyra më e lehtë për Prokurorin Publik që ta bëjë atë, në vend se të sillet Kryebashkiaku, N. Feriz GASHI, në gjykatë, vëllai i tij A. Isak GASHI dhe It. Isak GASHI. [...] Sipas mendimit tim, janë duke munguar disa deklarata nga këta njerëz. Tani jam pak i befasuar nga Prokurori Publik, sepse ai më akuzon mua për shtytje. [...] Më janë mohuar të drejtat elementare për të mbrojtur veten dhe ju lus të shkoni në vendin e krimit që të bindeni se çfarë ka ndodhur në ditën kritike...” (Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor të datës 24 mars 2009, fq.13).

Referencë i është bërë asaj që është vënë në pah më parë nën pikën B.II. të këtij aktgjykimi (fq. 10-14). Për më tepër, as avokati mbrojtës e as i akuzuari nuk e kanë specifikuar se deri në cilin nivel të ekzaminimit të vendit të krimit apo të marrjes në pyetje të personave të referuar do të shpinte në ndonjë rezultat tjetër të këtyre procedurave penale.

II. Dështimi i pretenduar në kryerjen e testeve shtesë të mjekësisë ligjore dhe të analizave tjera të provave fizike në dëm të të akuzuarit Feriz GASHI:

52. I akuzuari **Feriz GASHI** brenda ankesës së përbashkët që ai e ka ushtruar së bashku me babanë e tij, të akuzuarin **Hysni GASHI**, përfundimisht ka kundërshtuar në kontekst se në dëm të tij gjykata e shkallës së parë ka dështuar të kryejë prova shtesë dhe të analizojë provat tjera fizike, pasi që “... nga pengesat e paraqitura në mes të palëve ka qenë edhe teorikisht e pamundur të qëllohet mbi dy persona të pafat të cilët janë vlarë në ditën kritike”.

53. Lidhur me këtë Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ky shqetësim i të akuzuarit është pa merita prandaj edhe i pabazuar. Siç u përmend më herët, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar të gjitha provat në detaje në përgjithësi dhe gjithashtu një nga një, dhe në mënyrë të qartë ka bazuar gjetjet e saja dhe vendimin mbi këto prova. Pasi që këtë gjetje dhe vlerësimi nuk janë plotësisht të papranueshme ose tërësisht të gabueshme, Gjykata Supreme – siç e ka vënë në pah më herët – nuk do të zëvendësojë vlerësimin e provave siç është kryer nga Gjykata e shkallës së parë. Për më tepër, vlen të përmendet që



akuzuari ka dështuar të thotë, se cilat ekzaminime/prova shtesë ai sugjeron që të ndërmerren dhe deri në cilin nivel.

D. Vendimi i gabuar mbi sanksionin penal:

54. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, dy avokatët mbrojtës ashtu edhe dy të pandehurit si dhe palët e dëmtuara E F dhe G B; përmes përfaqësuesve të tyre ligjorë kanë kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me vendimet mbi sanksionet penale. Gjersa mbrojtja dhe të akuzuarit natyrisht janë duke synuar të shfaqësohen nga të gjitha akuzat, palët e dëmtuara kanë shprehur mendimin e tyre se vetëm burgimi afatgjatë do të përputhej me peshën e krimeve të kryera.

55. Gjykata Supreme në përgjithësi gjen se sa i përket dy të akuzuarve Gjykata e shkallës së parë drejt i ka marrë parasysh kufijtë e dënimit siç parashihen me dispozitat e KPK-së për veprat përkatëse penale të kryera nga të akuzuarit. Gjykata ka bërë një referim të përpunuar mirë mbi veprat e të akuzuarit **Feriz GASHI** si të neveritshme, rrëqethëse dhe të ndyrë dhe ka dhënë sqarime të duhura përkitazi me këto aspekte.

56. Përveç kësaj, është bërë vlerësimi i brutalitetit të jashtëzakonshëm të kryerjes së krimit.

57. Po ashtu janë marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese pasi që ekzistojnë aspekte psikologjike, veçanërisht lidhur me marrëdhëniet në mes **Hysni** dhe **Feriz GASHIT** si dhe fakti se kundër **Feriz GASHIT** nuk ka dosje të mëhershme penale.

58. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu gjen se dënimi i shqiptuar ndaj kryerësit kryesor **Feriz GASHI** është shumë i butë, duke marrë parasysh faktin se **Feriz GASHI** përveçse i ka vrarë dy njerëz të pafajshëm në rrugë, ai edhe ka rrezikuar jetët dhe ka lënduar rëndë shëndetin e shumë njerëzve tjerë që ishin përreth, kur filluan të shtënat. Përveç kësaj, ai ka gjuajtur tri granata dore, që fatmirësisht nuk kanë shpërthyer, por që në përgjithësi kanë rrezikuar seriozisht jetët dhe shëndetin trupor të shumë njerëzve në atë vendndodhje që do të kishte shkaktuar thjesht një masakër, po të kishin shpërthyer siç kishte pasur për qëllim i akuzuari. Prandaj, Gjykata Supreme ka ndryshuar Aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit **Feriz GASHI** dhe e zëvendësoi Vendimin e shkallës së parë me një dënim të ndarë për **Vrasje të rëndë** me 29 vjet [Neni 37 paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së dhe Neni 147 paragrafi 1, nën-paragrafët 4 dhe 11 të KPK-së] dhe për veprën penale **Mbajtje në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** me dy (2) vjet [Neni 38 dhe Neni 328 paragrafi 2 i KPK-së]; një dënim unik me tridhjetë (30) vjet është formuar prej këtyre dënimeve të ndara në përputhje me Nenin 71 paragrafin 1 dhe 2 pikën (2) të KPK-së.

59. Sa i përket të akuzuarit **Hysni GASHI** Gjykata Supreme gjen se Gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh drejt të gjitha rrethanat e veprës së kryer penale në cakimin e dënimit. E tërë kjo është bërë në përputhje me Nenin 64 të KPK-së.



E. Përfundimet e Gjykatës Supreme të Kosovës:

60. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se Ankesat kundër Aktgjykimit të Gjykatës së rigjykitimit të shkallës së parë (P 526/2009) refuzohen si të pabazuara dhe prandaj Aktgjykimi i shkallës së parë vërtetohet.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap.-Kz. Nr. 283/2009
PRISHTINË

Për arsyet e përmendura Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

Anëtare e Kolegjit

Kryetar i Kolegjit

Emine Mustafa

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e Kolegjit


Anëtar i Kolegjit

Nesrin Lushta

Salih Toplica

Anëtare e Kolegjit

Emine Kaçiku



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPIJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Punëtori i autorizuar
Dytrëceni radnik

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Z. Toplica", written over a horizontal line.

Mjeti juridik

Sipas Neneve 399, 400 dhe 430 paragrafit 1 pikës 1 së KPPK-së i pandehuri, Avokati mbrojtës, palët e dëmtuara dhe Prokurori Publik mund të paraqesin ankesë kundër këtij Aktgjykimi sa përket dënimit afatgjatë të shqiptuar me burg. Ankesa duhet t' i drejtohet Gjykatës Supreme të Kosovës dhe mund të paraqitet brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së Aktgjykimit te palët.

